

Shqipëria renditet në listën e vendeve që kanë shifra të larta të pacienteve që vuajnë nga tumoret ndërsa diagnostikimi i sëmundjes në shumicën e rasteve kapet në faza të avancuara. Jo pak por 3500 raste të reja në vit shënohen në vendin tonë të prekur nga tumoret, ndërsa femrat janë më të rrezikuara sidomos nga kanceri i gjirit. Këto të dhëna u bënë të ditura në konferencën Ndërkombëtare për tumoret. Femrat janë më të rrezikuara përse i përket kancerit të gjirit dhe atij në qafën e mitrës. Sipas mjekëve onkologë, këto dy patologji përbëjnë rreth 25% të të gjitha llojeve të tumoreve.

Përgjatë një viti në sistemin shëndetësor në vend, zbulohen 3500 raste të reja me kancer. "Kanceri i gjirit renditet i pari dhe zë 18% të të gjitha tumoreve malinje, kanceri i qafës së mitrës, përbën 6,2 % të të gjitha tumoreve. Gjatë një viti zbulohen 3000-3500 raste me kancer, 400 janë me kancer të gjirit, dhe 80-100 janë me kancer në qafën e mitrës", pohon Shahin Kadare, onkolog



"Kanceri i gjirit renditet i pari dhe zë 18% të të gjitha tumoreve malinje, kanceri i qafës së mitrës, përbën 6,2 % të të gjitha tumoreve. Gjatë një viti zbulohen 3000-3500 raste me kancer, 400 janë me kancer të gjirit, dhe 80-100 janë me kancer në qafën e mitrës",
pohon Shahin Kadare, onkolog

me kancer, 400 janë me kancer të gjirit, dhe 80-100 janë me kancer në qafën e mitrës", pohon Shahin Kadare. Shqipëria renditet e fundit në Evropë përse i përket rasteve të zbuluara me kancer, por kjo situatë pritet të ndryshojë negativisht, pasi mjekët onkolog japin alarmin se tumoret e gjirit apo ato të qafës së mitrës po përhapen me ritme të shpejta. Sa i përket vdekshmërisë, kanceri renditet e dyta sëmundje pas atyre kardiovaskulare. Të dhënat tregojnë se në 20 vitet e fundit është shtuar ndjeshëm numri i pacienteve që vuajnë nga lloje të ndryshme të tumoreve duke e dyfishuar atë krahasuar me vite më parë. "Nga viti 90 deri në vitin 2010 ne kemi dyfishim të rasteve me kancer në Shqipëri. Si në mbarë botën dhe në vendin tonë nuk bëjnë përjashtim te meshkujt kanceri që prek më tepër mushkërinë dhe të femrat kanceri i gjirit", - pohon shefi i onkologjisë Agim Sallaku.

tjetër mjekëzish që shesin antibiotikë, edhe ata që largohen për të jetuar jashtë vendit familjarisht. "Në fakt ata që vijnë dhe i shesin ndihen vërtet keq për atë çka bëjnë por duket se janë të detyruar për ta bërë këtë dhe kjo për fare pak lekët në këmbim të një pasurie të cilën e kanë vendosur prej vitesh", - pohon një tjetër librashitës.



Specia u zbulua në rajonin malor të Shqipërisë veriore me anë të përdorimit të kamerave-kurth

Zbulohet rrëqebulli i parë i Ballkanit në veri

Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) ka konfirmuar dje ekzistencën e Rrëqebullit të Ballkanit (*Lynx lynx martinoi*) në gjendje të egër, në rajonin malor të Shqipërisë veriore me anë të përdorimit të kamerave-kurth. Shoqata gjithash pohoi se është hera e parë që ekzistenca e kësaj specie në vendin tone dokumentohet nëpërmjet fotografive. Vlerësimet më të fundit të ekspertëve tregojnë se numri i këtij lloji në Shqipëri nuk i kalon 15-20 individë në total dhe si i tillë është i klasifikuar si një lloj i kërcënuar në mënyrë kritike. Nga kërkimet e PPNEA-s ndër vite me metoda bashkëkohore shkencore, deri më sot nuk ishte provuar prania e rrëqebullit në gjendje të egër në Shqipëri dhe shenjat e prezencës së tij vinin kryesisht nga individë të vvarë dhe të ruajtur si trofe ose nga informacione të rastësishme të marra nga popullsia e zonave rurale. Si rrjedhojë, ky është një nga

rezultatet më të rëndësishme të arritura deri më tani pasi provon praninë e rrëqebullit në vendin tonë dhe përbën një thirrje të fuqishme për marrjen e masave të menjëhershme për ruajtjen e tyre dhe të habitateve ku ata jetojnë. Rrëqebulli është një lloj plotësisht i mbrojtur dhe gjuetia e tij ndalohet rreptësisht në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Faunës së Egër dhe Ligjit për Gjuetinë Rrëqebulli ka pasur një mbrojtje të plotë ligjore në vendin tone që prej vitit 1969. Ai klasifikohet në Listën e Kuqe të Shqipërisë me statusin CR, ndryshe i rrezikuar në mënyrë kritike për zhdukje. Situata e rrëqebullit të Ballkanit është edhe më alarmante po të mendohet se ai përbën një popullatë dhe nënloj (subspecie) më vete dhe të diferencuar gjenetiksht nga popullatat e rrëqebujve të tjerë nëpër botë. Kësisoj, ai ka vlera të mëdha për diversitetin biologjik dhe trashëgiminë natyrore të vendit tonë dhe përbën një thesar të natyrës shqiptare.



Në gjithë vendin numërohen 20 individë të tillë